

L I G J
PER PLOTESIMIN E LIGJIT PER QEVERINE E REPUBLIKES SE MAQEDONISE

Neni 1

Ne Ligjin per Qeverine e Republikes se Maqedonise ("Gazeta zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 59/2000, 12/2003, 55/2005, 37/2006, 115/2007, 19/2008 dhe 82/2008), pas nenit 39 shtohet Kapitull i ri XI-a me tre nene te reja 39-a, 39-b dhe 39-v, si vijojne:

"XI-a. SEKRETARI SHTETEROR

Neni 39-a

- (1) Sekretari shteteror emerohet ne ministri, Sekretariatin per Ceshtje Evropiane dhe ne Sekretariatin per Implementimin e Marreveshjes Kornize.
- (2) Sekretarin shteteror e emeron Qeveria me propozimin e ministrit, perkatesisht funksionarit i cili udheheq me organin nga paragrafi (1) i ketij neni.
- (3) Sekretari shteteror e ka statusin e funksionarit.
- (4) Sekretari shteteror per punen e vet pergjigjet drejtperdrejt para Qeverise dhe ministrit, perkatesisht funksionarit i cili udheheq me organin nga paragrafi (1) i ketij neni.

Neni 39-b

Mandati i sekretarit shteteror perfundon me mandatin e Qeverise.

Neni 39-v

- (1) Sekretari shteteror me punen e vet siguron pune efikase dhe efektive te organit, si dhe bashkimin e punes se organit; udheheq me sherbimin profesional te organit dhe u jep udhezime nepunesve udheheqes dhe nepunesve tjere, vecanerisht ne kontekst te menaxhimit me resurset njerezore; pergjigjet per perparimin e organizimit dhe kushteve te punes se organit, rregullsine dhe azhurnimin e punes per lendet dhe kryerjen e puneve ne organ, si dhe zbatimin dhe realizimin e planit strategjik, programit te punes dhe buxhetit te organit; kujdeset per zbatimin ne kohe te vendimeve dhe konkluzioneve te Qeverise, si dhe drejtimet dhe udhezimet e funksionarit i cili udheheq me organin; merr pjese ne punen e Kolegjiut te Pergjithshem te Sekretareve Shteterore; koordinon me pergatitjen e raporteve, propozimeve, programeve, informatave dhe materialeve tjera, si dhe materialeve per mbledhjet e Qeverise, drejtperdrejt bashkepunon me Sekretarin e Pergjithshem te Qeverise, me sekretaret dhe funksionarët tjere te cilet udheheqin me organe tjera; mban kontakte ne nivel perkates me organizata te vendit dhe nderkombetare, kur eshte i autorizuar per kete merr pjese ne punen e trupave punuese te Kuvendit te Republikes se Maqedonise dhe Qeverise se Republikes se Maqedonise dhe kryen edhe pune te tjera.
- (2) Sekretari shteteror i kryen edhe punet te cilat i kryejne sekretaret lidhur me te drejtat, obligimet dhe pergjegjesite e nepunesve shteterore ne pajtim me Ligjin per nepunes shteterore.

Neni 2

Sekretaret shtetërore të emëruar para ditës së fillimit të zbatimit të këtij ligji, vazhdojnë ta kryejnë funksionin si sekretarë shtetërore në pajtim me këtë ligj.

Neni 3

Sekretaret shtetërore të emëruar nga radhët e nepunësve shtetërore udhëheqës, në pajtim me Ligjin për nepunës shtetërore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 6/2009 dhe 114/2009), para ditës së fillimit të zbatimit të këtij ligji, pas skadimit të mandatit sistemohen në vend pune me titullin që e kanë pasur para se të emërohen si sekretarë shtetërore.

Neni 4

Me fillimin e zbatimit të këtij ligji, shfuqizohen dispozitat nga nenet 6-a paragrafi 2 dhe 11 paragrafi 2 dhe në nenin 36 paragrafi 2 fjalet: "I sekretari shtetëror" dhe numri "625" nga Ligji për nepunës shtetërore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 6/2009 dhe 114/2009).

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazeten zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 22 marsi 2010.